

Titulli i lëndës: HYRJE NË PËRKTHIM DHE INTERPRETIM

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë: Departamenti i gjuhës dhe i letërsisë gjermane
Titulli i lëndës:	Hyrje në përkthim dhe interpretim
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Me zgjedhje
Viti i studimeve:	Viti II, semestri II
Numri i orëve në javë:	2 + 0
Kreditë ECTS:	3 ECTS
Koha / Vendi:	Klasa 32, sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. dr. Naim Kryeziu
Të dhënat kontaktuese:	naim.kryeziu@uni-pr.edu naimkryeziu@bluewin.ch
Përshkrimi i lëndës:	Lënda “Hyrje në përkthimin me shkrim dhe në përkthimin me gojë” synon t’i njohë studentët me teoritë e ndryshme, me metodologjitë e me strategjitë e përkthimit me shkrim dhe të përkthimit me gojë, si edhe me vështirësitë që mund të hasin përkthyesit e ardhshëm në këto dy procese të përkthimit. Gjatë zhvillimit të ligjëratave të kësaj lënde, studentët do të njihen me teknikat më thelbësore për përkthim me shkrim e për përkthim me gojë, ndërsa gjatë ushtrimeve përkatëse do të mësojnë se si duhet përvetësuar arti i këtyre dy lloje përkthimesh, se si duhet bërë hulumtimi paraprak, si duhet punuar me fjalorë, ku dhe si mund të marrin informacione nga burimet elektronike, etj. Studentët do të mësojnë gjithashtu që të mos i bartin në mënyrë mekanike rregullat sintaksore nga njëra gjuhë në tjetrën. Njohuritë e fituara gjatë zhvillimit të kësaj lënde, studentët do t’i zbatojnë në praktikë, duke përkthyer me shkrim e me gojë tekste e biseda të niveleve e të fushave të ndryshme.

Qëllimet e lëndës:

Qëllimi i kësaj lëndë është që t'i njohë studentët:

- me teoritë, me metodologjitë dhe me strategjitë e përkthimit me shkrim e me gojë
- me burimet e informacioneve që mund t'u nevojiten gjatë këtyre dy proceseve të përkthimit
- me praktikat profesionale të përkthimit me shkrim e me gojë nga gjermanishtja në shqip dhe anasjelltas.

Rezultatet e pritshme të nxënies:

Pas mbarimit të kësaj lënde, studenti duhet të ketë përvetësuar:

- metodat kryesore të përkthimit me shkrim e me gojë në përgjithësi
- praktikat profesionale të përkthimit me shkrim e të përkthimit me gojë
- veçoritë më thelbësore të gjuhës nga e cila përkthen dhe të gjuhës në të cilën përkthen me shkrim ose me gojë
- njohuritë themelore të teorisë e të praktikës së përkthimit me shkrim dhe të përkthimit me gojë
- rëndësinë e përdorimit të frazeologjisë, të sinonimisë dhe të antonimisë së gjuhës në të cilën përkthen me shkrim ose me gojë.

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	10 min.	15	2.25
Punim seminari	7	1	7
Detyrë shtëpie	1	15	15
Mësimi individual (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgatitje për biseda ndërvepruese në lidhje me leksionet e zhvilluara	3	1	3
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi përfundimtar)	1.5	1	1.5
Projektet, prezantimet, etj.	30 min	1	0.50
Total			74.5:25=2.98 3 ETCS

Metodat e mësimdhënies:	Mësimi zhvillohet me ligjërata dhe me ushtrime. Gjatë ushtrimeve zbatohet metoda ndërvepruese. Ushtrimet bëhen sipas temave dhe detyrave të caktuara. Ushtrimet zhvillohen në grupe e në çifte, por edhe në mënyrë individuale. Studentët janë të detyruar të bëjnë punime seminari dhe të përkthejnë tekste nga fusha të ndryshme.
Metodat e vlerësimit:	<ul style="list-style-type: none"> • Pjesëmarja aktive dhe detyrat 20 % • Testi i parë 30 % • Provimi përfundimtar (me shkrim/me gojë) 50%
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Verlag: Narr Verlag, 2011 "Übersetzungstheorien: Eine Einführung" Autor: Radegundis Stolze ISBN-13: 978-3823366799 2. Verlag: Utb, 2011 "Einführung in der Übersetzungswissenschaft" Autor: Werner Koller ISBN-13: 978-3825235208 3. Verlag: Gunter Narr Verlag, 2009 "Verstehen und Übersetzen. Ein Lehr- und Arbeitsbuch" Autor: Paul Kussmaul ISBN-13: 978-3823365426
Literatura shtesë:	4. <i>Übersetzungswissenschaft / Eine Neuorientierung</i> . 2. Auflage, Autor: Mary Snell-Hornby, UTB für Wissenschaft Francke Verlag Tübingen und Basel, ISBN 3-8252-1415-X, 1994 Tübingen

Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjërates
Java 1:	Hyrje në shkencat e përkthimit me shkrim dhe të përkthimit me gojë.
Java 2:	Teknikat dhe metodat e përkthimit me shkrim dhe të përkthimit me gojë.
Java 3:	Përkthimi me shkrim dhe përkthimi me gojë.
Java 4:	Llojet e përkthimit me gojë.
Java 5:	Përkthimi me gojë.
Java 6:	Kuptimi i teksteve, përkthimi i teksteve dhe kritika e përkthimeve. Përkthyesi me gojë dhe gjuhët: Gjuha-A, Gjuha-B dhe Gjuha-C.
Java 7:	Rëndësia e shpjegimit kuptimor dhe gjuhësor të tekstit gjatë përkthimit.
Java 8:	Çfarë duhet të zotërojë përkthyesi me shkrim dhe përkthyesi me gojë

Java 9:	Kërkesat ndaj një përkthyesi me shkrim dhe ndaj një përkthyesi me gojë.
Java 10:	Përkthyesit me shkrim dhe përkthyesit me gojë të fushave të veçanta (në gjykata, spitale, shkolla, institucione të ndryshme administrative, etj.).
Java 11:	Përgjegjësitë e përkthyesve me shkrim dhe të përkthyesve me gojë
Java 12:	Përkthyesi dhe formulimi i teksteve.
Java 13:	Detyrat e përkthyesit dhe përgatitja për të ushtruar rolin e përkthyesit.
Java 14:	Analiza e gabimeve në tekstet e përkthyer me shkrim dhe në përkthimet me gojë.
Java 15:	Mundësitë e përkthyesve për specializim. Specializimi akademik i përkthyesve.

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Studentët duhet të vijnë me kohë në auditor, sepse ardhja me vonesë sjell ndërprerjen e mësimit dhe pengon, çrregullon e shpërqendron vëmendjen e studentëve. Gjatë orës së mësimit nuk lejohet përdorimi i mjeteve elektronike, sepse shkaktojnë zhurmë ose pengesa të tjera.

Hartoi: Prof. dr. Naim Kryeziu/26.02.2025/NKr